
Lënda: Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objekteve të finacuara nga Bashkia Tiranë për periudhën kohore nga viti 2012 deri në vitin 2018.

Objekti: Rikonstruksion "Rruga e Zallit", Selitë Tiranë

Investitori: Bashkia Tiranë

Vlera e Investimit: 140,254,570 leke

Periudha kohore: Nëntor 2016 deri në Korrik 2018

Inspekimi është kryer: Dhjetor 2018

Ky objekt zbatohet në qytetin e Tiranës. Segmenti rrugor nis nga bashkimi i "Rrugës së Zallit" me rrugën "Isuf Elezi" dhe përfundon pothuajse në bashkimin e ketij segmenti rrugor me fundin e rrugës "Kodra e Diellit", me një gjatësi të përgjithshme rreth 1 km.

Projekti ka ndërhyrë në ndertimin e të gjitha shtresave rrugore të trupit të rrugës, në ndertimin e mureve mbajtës dhe pritës të saj, në rrjetin e ujrave të bardha e të zeza, në uniformitetin e gjerësisë së trupit të rrugës, në sistemimin e trotuareve, në vendparkime anësore, në rrjetin e ndriçimit, në mbjelljen e pemëve (gjelbërimin), në sinjalistikë rrugore, etj. Projekti zbatimit ka parashikuar ndërtimin e plotë të ketij segmenti rrugor, me të gjithë komponentët e tij.

Punimet kanë filluar rreth fundit të vitit 2016, ndërkohë që është bërë inagurimi për përfundimin e saj në muajin Korrik 2018 që përkon edhe me përfundimin e deklaruar nga Bashkia Tiranë. Afati i garancisë së punimeve për këtë tipologji ndërtimi është dy vite. Pra rezulton se akoma nuk ka përfunduar afati kohor i garancisë së punimeve të veprës. Edhe pse zbatimi i punimeve është bërë në kushte shumë optimale, cilësia e punimeve të veprës lë shumë për të dëshiruar. Kujtojmë këtu se segmenti rrugor gjatë rikonstruksionit të tij ka qenë pothuajse i bllokuar për levizjen e mjeteve motorike.

Nga pamja vizuale e objektit konstatojmë se:

- Trupi i rrugës ka levizje dhe plasaritje shumë të shpeshta e të theksuara të shtresave të asfaltit;
- Ka ulje e levizje të pllakave të trotuareve, si dhe thyerje e dëmtime të tyre;
- Plasaritje të një pjese të mureve mbajtës e pritës të rrugës;
- Plasaritje e dëmtime të kunetave anësore të rrugës;
- Ndërtim jo uniformë të mureve mbajtës e pritës të saj (në disa mure janë akoma pa prerë fitilat e hekurave, duke u bërë rrezik evident për përdouesit e rrugës);



Fig 1 dhe 2

Trotualet jane jo te njetrajtshem me mungese te elementeve lidhes me pusetat dhe me levizje te shumta per sa i perket nivelit te tyre

- Mungesa të shumta të pemëve në trotuare, ndërkohë që edhe ato që janë vendosur janë shumë të vogla, apo të demtuara;
- Ka patur mosfunksionim të kanaleve të ujrave të bardha gjatë rreshjeve të fundit; Puseta të dëmtuara e jo uniformë (me mure anësore të tyre dhe kapake të dëmtuar).



Fig 3

Jane parashikuar mbjellja e pemeve dekorative, por vendet perkatese per mbjellje jane ndertuar vetem ne pjesen fundore te rruges.

Edhe ne hapsirat ne te cilat jane mbjelle peme dekorative, keto te fundit nuk jane ten je standardi te pranueshem

Ka më shumë se dy muaj pas përfundimit të inagurimit të saj, edhe pse është nderhyrë për riparimin e disa defekteve të shfaqura, më rezulton se cilësia e zbatimit të punimeve për këtë objekt, vijon të jetë në kushte jo shumë të mira.

Bashkia Tiranë si investitore e këtij objekti, ka gjithë detyrimin ligjor për

kontrollin e zbatimit të punimeve të ndertimit. Jam i mendimit se si nga mbikqyrësi i punimeve por edhe nga Bashkia Tiranë ka patur një neglizhence totale në kontrollin e zbatimit të punimeve të këtij segmenti rrugor shumë të rëndësishëm e me vlerë të konsiderueshme. Me gjithë këto defekte të shfaqura, firma zbatuese e punimeve do duhej në mënyrë të menjëhershme të bënte me fondet e veta (plus fondin e garancisë së punimeve) riparimin e menjëhershëm të tyre, pa pritur degradimin e metejshëm të saj. nëse firma zbatuese nuk tregohet e gatshme për këto riparime shumë të domosdoshme, atëherë institucioni i Bashkisë Tiranë, do duhet të konfiskonte menjëherë fondin e garancisë së punimeve (fondi garancisë është 5% e vlerës së situacionit përfundimtar).

Gjithashtu Investitori (Bashkia) do duhet të kerkojë menjëherë pranë APP edhe përjashtimin e kompanisë zbatuese për mospjesëmarrje në tenderat pranë Bashkisë Tiranë, duke e evidentuar për punë me cilësi shumë të dobët.

Fig 4
Trotuaret jane te demtuara per shkak te cilesise se ulet te punimeve



Fig 5
Elementet lidhese me rruget anesore mungojne dhe jane gjetur menyra rrethanore per te kanalizuar ujrat e bardha



Fig 6
Vetem pak muaj pas ndertimit, rruga ka pesuar nderhyrje te shumta per shkak te mungeses se cilesise ne shtresat asfaltike apo planifikimin e kanalizimeve te ujrave te bardha/zeza dhe lidhjet elektrike



Fig 7
Cilesia e materialeve lidhese te kornizave te kanalizimeve anesore eshte tejet e ulet. Kjo ka cuar ne demtimin e tyre te plote vetem pak muaj pas instalimit




Fig 8
Firma zbatuese ka kryer instalim te gabuar te shtyllave te ndricimit dhe kutive te sherbimit te tyre

Konkluzione në lidhje me objektin.

- Do duhen të riparohen të gjitha uljet e shtresave të asfaltit në trupit e rrugës.
- Të bëhet riparimi i trotuareve (uljet e tyre), si dhe zëvendësimi i të gjitha pllakave prej betoni të parapergatitura e të thyera në to.
- Të përforcohen një pjesë e mureve mbajtës të trupit të rrugës, për të mos lejuar rrëshqitjen e mëtejshme të tyre.
- Të bëhet riparimi i plotë i të gjitha pusetave të ujrave të bardha e të zeza dhe plotësimi i tyre me kapakët metalike (një pjesë e tyre janë thyer ose mungojnë plotësisht në objekt).
- Të bëhet riparimi i kunetave anësore të rrugës në të dy krahët e saj dhe të bëhet lidhja në mënyrë uniforme e saj me shtresat e asfaltit të trupit të rrugës.



Fig 9

Ne shume raste, kapaket e pusetave te sherbimit mungojne dhe trotuaret anesore jane te zena nga material inerte



Fig 10

Cilesia e punimeve ne kete segment rrugor eshte teresisht nen standardet e percaktuara ne legjislacionin ne fuqi

-
- *Sipas mendimit tonë vlera për riparimin e defekteve të vërejtura zënë rreth 35 deri 40 % të vlerës së situacionit përfundimtar.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarde të kontratave të zbatimit të punimeve, si dhe në Udhezimin e Keshillit të Ministrave Nr 3, Datë 15.01.2001, Nr 2, datë 13.05.2005 dhe Nr 1, datë 16.06.2011, "Për mbikqyrjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".